



**PHD (CAND.) ERION
MUÇA**

Lektor

Departamenti të Shkencave të
Edukimit dhe Trajnimit Profesional

Drejtues ekzekutiv
“SFIDAT” dhe “STEAM+ Albania”

KONTAKTE

✉ e.muca@umb.edu.al



PHD (CAND.) ERION MUÇA

Lektor

Departamentit të Shkencave të
Edukimit dhe Trajnimit Profesional

Drejtues ekzekutiv
“SFIDAT” dhe “STEAM+ Albania”

BIOGRAFIA

PhD (cand.) Erion Muça është pedagog me kohë të plotë pranë Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional në Universitetin Barleti, ku drejton gjithashtu Strukturën e Trajnimeve, si dhe drejtues ekzekutiv i programeve për mbështetjen e talentëve të reja “SFIDAT” dhe “STEAM+ Albania”. Ai është një kërkues aktiv në fushat e edukimit, karrierës, punësimit dhe emigracionit, si dhe konsulent për çështje të biznesit, marketingut dhe PR-it, opinionist dhe gazetar. Ka një përvojë të gjatë dhe të larmishme profesionale e akademike si pedagog, studiues dhe kërkues shkencor/aplikativ, me specializim të thelluar edhe në çështjet e kapitalit njerëzor, projekteve, standardizimit dhe modernizimit të sipërmarrjeve. Ka mbajtur funksione të ndryshme me kohë të plotë dhe të pjesshme si drejtues projektsh, ekspert marketingu, PR-i, trajner për individë, staf sipërmarrjesh dhe CEO-sh. Gjatë karrierës ka hartuar dhjetëra programe, manuale dhe kurrikula në fushat e tij të ekspertizës dhe ka shërbyer si këshilltar për projekte, punësim dhe emigracion për drejtues institucionesh të ndryshme. Është anëtar i rrjeteve europiane EU STEM Coalition dhe European Talent Support Network (ETSN), si dhe njohës i zhvillimit profesional përmes kurseve dhe trajnimeve. Aktualisht kontribuon me kërkime dhe studime shkencore në nivel europian mbi rolin dhe ndikimin e inteligjencës artificiale në edukim dhe është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në media mbi çështje sensitive të fushës së tij. Ka qenë dhe është pedagog me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Fushat e tij të ekspertizës përfshijnë edukimin, punësimin, karrierën, emigracionin, menaxhimin, burimet njerëzore, trajnimet, konsulencën, median, marketingun, komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun.